

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2022/2023  
(java e 11, deri më 19.03.2023)

Të dhëna javore


Gjatë javës së njëmbëdhjetë të vitit 2023 (13.03-19.03.2023), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar gjithsej 331 ( $I=18,0/100.000$ ) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, 28,4% më pak se javën e kaluar.

Numri i rasteve të raportuara gjatë kësaj jave, krahasuar me javën e njëmbëdhjetë të sezonit të kaluar ( $n=12$ ) është më i madh për 27,6 herë, ndërsa krahasuar me numrin e rasteve për javën e njëmbëdhjetë sipas lakores tipike epidemike (e modeluar sipas 12 sezoneve të fundit) ( $n=912$ ) është zvogëluar për 63,7%. (Grafiku 1)

Gjatë javës së njëmbëdhjetë, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 61 materiale për analiza laboratorike për gripin paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19 dhe 3 (4,9%) kanë rezultuar pozitive për prani të virusit të gripit, 2 Influenza A/H1pdm dhe 1 Influenza B/Victoria (Grafiku 3).

Tashmë nëntë javë rresht incidenca e raportuar është nën kufirin sezonal të virusit të gripit ( $I=18,0/100.000$ )(Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores së pritur epidemike 2010-2022, sezoni 2021/2022 dhe sezoni 2022/2023




Sipas moshës, 200 persona i përkasin grupmoshës nga 15-64 vjet, 60 janë fëmijë nga 5-14 vjet. Incidencë më e lartë (32,7/100.000) është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

Raste të të sëmurëve kanë raportuar nga 21 QShP/NjR, Dibër – 58, Kavadar-52, ndërsa në qytetet e tjera numri i rasteve është nën 40.

13 njësi të raportimit këtë javë kanë raportuar për aktivitete shumë të ulët të gripit, ndërsa 7 sezonal dhe 1 aktivitet shumë të lartë të virusit të gripit. (Hartogrami 1).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e njëmbëdhjetë 2023




## МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE -Të dhëna kumulative

Në sezonin 2022/2023 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 9.655 ( $I=525,7/100.000$ ).

Krahasuar me të njëjtën periudhë gjatë sezonit të kaluar ( $n=3.668$ ), numri i rasteve të raportuara është për 2,6 herë më i lartë, ndërsa në raport me modelin për 12 vitet e fundit ( $n=21.038$ ) është regjistruar një rënie prej 54,1%.

Raste të gripit kanë raportuar 30 QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve ( $n=1.501$ ) është regjistruar në Strumicë, Gostivar ( $n=881$ ) dhe Dibër (799), ndërsa incidencë më e lartë kumulative ( $4.176,2/100.000$ ) në territorin e Dibrës. (Tabela 1)

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sipas QSHP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2022/2023



Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshave, numër më i madh të të sëmurëve sipas grupmoshave është raportuar tek grupmosha nga 15-64 vjet - 6.010 (62,2%) ndërsa incidencë më e lartë (1.053,7/100.000) tek fëmijët nga 0-4 vjet (n=1.017). (Tabela 1)

Shpërndarja e rasteve i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve (Tabela 1):

- tetor – 62 raste ose 0,6%
- nëntor – 82 raste ose 0,8%
  - dhjetor – 786 raste ose 8,1%
  - janar – 4.176 raste ose 43,3%.
  - shkurt – 3.087 raste ose 32,0%.
  - mars – 1.462 raste ose 15,1%.

Deri më tani janë regjistruar 4 raste të vdekjes si pasojë e gripit, 3 nga Shkupi dhe 1 nga Shtipi, 3 nga të cilët i përkasin grupmoshës 15-64 vjet dhe 1 mbi 65 vjet, me komorbiditete, të shtruar në spital dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal.

#### MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyria rutinore) – Të dhëna kumulative

Që nga fillimi i sezonit 2022/2023, deri më javën e njëmbëdhjetë, për analiza laboratorike për gripin kanë arritur 5.723 materiale, nga mbikëqyrja rutinore.

Janë regjistruar 223 raste pozitive, 93 Influenza A/H3, 89 influenza A/H1pdm dhe 30 Influenza A e pasubtipizuar 8 Influenza B Victoria dhe 1 Influenza B. (Grafiku 3)

## MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shitesë e sistemit të rregullt për mbikëqyrje të gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohen informacione më të detajuara në lidhje me incidencën, intensitetin, llojin e virusëve që qarkullojnë që të mundësohet një reagim në kohë me masa adekuate.

Mbikëqyrja SARI sentinel zbatohet në 7 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU të sëmundjeve infektive dhe gjendjeve febrile, KU të sëmundjeve të fëmijëve, KU të pulmoalergologjisë, ShPQ 8 Shtatori dhe ISMF Kozle) dhe një në Prilep (SP Prilep) dhe Shtip (SK Shtip). Definicioni për një rast të SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja.

Nga këto vende, gjatë kësaj jave janë raportuar gjithsej 52 raste SARI. Numri më i madh është raportuar nga KU e sëmundjeve të fëmijëve (n=20; 38,5%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=22; 42,3%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë javës së njëmbëdhjetë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 177, me 8 raste në kujdes intensiv. Gjatë kësaj jave 29,4% e të gjitha pranimeve janë në për SARI. Ngarkesë më e madhe prej 80% vihet re tek personat 15-29 vjet.

Gjatë javës së njëmbëdhjetë, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 23 materiale nga SARI të raportuara për analiza laboratorike për gripin paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19. 4 (17,4%) kanë rezultuar pozitive për prani të virusit të gripit – nga 2 Influenza A/H1 dhe Influenza B/Victoria. Në 2 mostra është vërtetuar COVID-19. Gjatë kësaj nuk ka mostra SARI që janë testuar për virus sincicjal respirator dhe viruse të tjerë.


Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 1197 raste SARI, të gjitha nga sentinel SARI vendet në Shkup dhe Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI (n=472; 39,4%) janë raportuar në KU e fëmijëve. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=645; 53,9%).

Kumulativisht, numri i pranimeve në vendet sentinel është 4.490, nga të cilët 186 në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 26,7% janë për SARI. Ngarkesë më e madhe 35,2% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Kumulativisht, për analiza laboratorike janë dorëzuar 447 materiale nga rastet e raportuara SARI. Janë regjistruar 89 (19,9%) raste pozitive me grip, 54 Influenza A/H1pdm, 17 Influenza A/H3, 10 Influenza B/Victoria 7 Influenza A e pasubtipizuar, dhe një Influenza B e pasubtipizuar.

Janë regjistruar 21 raste pozitive të KOVID-19. Nga mostrat SARI, 84 janë testuar për virusin sincicjal respirator dhe 42 kanë rezultuar pozitive. Tek 9 mostra është detektuar prani e Adeno Virusit, ndërsa tek një – Entero virus. (Grafiku 3).

Grafiku 3. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindja e rasteve pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, Republika e Maqedonisë së Veriut 2022/2023



## KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rënie e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin në tre javët e fundit, i cili është nën kufirin javor për aktivitet sezonal. Rezultatet e fituara nga mbikëqyrja virusologjike janë nën kufirin e pozitivitetit 10%. Sipas këtyre të dhënave RMV ka një përhapje sporadike gjeografike dhe intensitet mesatar të aktivitetit të virusit të gripit.

## VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe

- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2022 /2023, Ministria e shëndetësisë siguroi 40 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2022/2023 filloi në 19.10.2021 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

Sipas të dhënave nga Drejtoria për shëndetësi elektronike, që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 52.774 persona të grupeve të rrezikuara të popullatës me vakcina falas. Sa i përket vaksinave komerciale 2.633 persona.

6.000 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Deri në javën e njëmbëdhjetë në RMV janë vaksinuar gjithsej 55.407 persona me vakcina komerciale.

## RAJONI EVROPIAN

\*BURIMI: <https://flunewseurope.org/>

Sipas raportit të Flu News Europe të publikuar për javën e dhjetë të vitit 2023, për aktivitetin e virusit të gripit në mbarë rajonin Evropian.

- 19 nga 40 vende kanë raportuar intensitet të lartë ose mesatar dhe 20 nga 39 vende përhapje të gjerë të virusit të gripit, që flet për një qarkullim të lartë të gripit në rajon.
- Përqindja e të gjitha mostrave në mbrojtjen shëndetësore primare sentinel është 26%.
- Janë detektuar edhe Influenza A edhe Influenza B, me një dominancë të Influenza B në mbikëqyrjen sentinel dhe në atë të rregullt.
- Janë raportuar hospitalizime të rasteve të konfirmuara në laborator nga repartet e kujdesit intensiv, repartet e tjera dhe nga mbikëqyrja SARI. Dominjnë infeksionet me influenza A/H1pdm09.

Sipas treguesve kualitativ në raport me intensitetin, 6 vende janë në nivel bazik, 15 nivel të ulët, 18 me intensitet mesatar, 1 me intensitet të lartë të aktivitetit të virusit të gripit.

Sipas shpërndarjes gjeografike, 7 vende kanë raportuar raste sporadike, 4 vende shpërndarje lokale, 7 përhapje rajonale, ndërsa 20 vende shpërndarje të gjerë.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive

Instituti i Shëndetit Publik